



Prishtinë: 17.06.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_368\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_591\_05\_11

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_591\_05\_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 02.06.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2011 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i konsumatorit Xhezide Sogojeva (parashtruesi i ankesës Ismet Sogojeva), shifra e konsumatorit DPR – 50689, nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 28.06.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 14.06.2010, lidhur me kontestimin e borxhit.

- Me datë 18.12.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se shtëpia e konsumatorit Xhezide Sogojeva është e rrënuar, por që në të njëjtin oborr djali Ismet Sogojeva ka ndërtuar shtëpi të re. Ekipi për inspektimin e pikave matëse kanë konstatuar se nuk mund të vendoset njehsori elektrik pasi nuk plotësohen kushtet teknike pasi tabela e vendosjes së njehsorit është brenda shtëpisë e që do të duhej të ishte jashtë.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 067785 i datës 18.12.2009
- Me datë 21.01.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se konsumatori nuk posedon njehsor elektrik por që furnizohet direkt nga rrjeti, kanë regjistruar pajisjet që posedon konsumatori si dhe kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin .  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 221889 i datës 21.01.2010
- Me datë 11.06.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se shtëpia e konsumatorit Xhezide Sogojeva është e djegur gjatë luftës dhe së bashku me të edhe njehsori elektrik. Konsumatori i cili banon në shtëpinë e re nuk posedon njehsor elektrik por që furnizohet direkt nga rrjeti si dhe konsumatori shkyçet nga rrjeti në shtyllë.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 153075 i datës 11.06.2010



- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 14.06.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në proceset e kontrolluese nr. 067785 të datës 18.12.2009, nr. 221889 të datës 21.01.2010, nr .0294867 datë 18.05.2010 dhe procesverbalit nr. 153075 datë 11.06.2010  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 14.06.2010
- Me datë 28.06.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 20.05.2011, DMK ka lëshuar vendimin duke aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:
  1. Hap shifër të re për konsumatorin Ismet Sogojeva (parashtruesi i ankesës) dhe bartë shpenzimet e energjisë elektrike nga shifra DPR – 50689 nga periodha 07/2008 e tutje në shifrën e re.
  2. KEK-u duhet të udhëzojë konsumatorin lidhur me kushtet teknike për vendosjen e njehsorit elektrik.
  3. Konsumatori obligohet që të veproj sipas rregullës për kushtet e përgjithshme për lidhje të reja dhe plotësoj të gjitha kushtet teknike të paraparë në kode.
- Me datë 02.06.11 konsumatori ka apeluar përgjigjen e DMK në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_ 591\_05\_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: ZRRE/DMK\_V\_ 591\_05\_11 të mbetet në fuqi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar